



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 19.3.2021

Dokument parlamentar

Komision përgjegjës

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË VEÇANTË PËR NEGOCIIMIN DHE EKZEKUTIMIN E KONTRATËS ME SHOQËRINË “BECHTEL INTERNATIONAL, INC.” , PËR PROJEKTIMIN DHE NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TË SKAVICËS”

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 19 mars 2021, shqyrtoi projektligjin “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe ekzekutimin e kontratës me Shoqërinë “Bechtel International, Inc.”, për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës”. Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj sipas rregullave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relator, për këtë projektligj, z. Anastas Angjeli.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë:

- Znj. Belinda Balluku, Ministre;
- Znj. Viola Haxhiademi, Sekretare e Përgjithshme;
- Z. Enea Karakaçi, Drejtor i Drejtorisë Juridike.

II. Baza ligjore.

Këshilli i Ministrave e ka propozuar projektligjin bazuar në nenet 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës. Projektligji shoqërohet me relacionin përkatës, sipas kërkesave të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit.

Qëllimi i projektligjit është përcaktimi i procedurës së veçantë për negocimin, ekzekutimin dhe miratimin e kontratës me Shoqërinë “Bechtel Internacional”, Inc. ose një filial të saj, për projektimin dhe ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës, bazuar në shprehjen e interesit paraprak të depozituar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Projektligji është hartuar në kuadër të nevojave që ka vendi ynë për rritjen e prodhimit të energjisë elektrike dhe të shprehjes së interesit nga Shoqëria Bechtel që të japë kontributin e saj në projektimin, ndërtimin dhe sigurimin e financimit për Hidrocentralin e Skavicës. Për ndërtimin e këtij hidrocentrali ka pasur disa projekte ndër vite, por ato nuk kanë arritur të vihen në zbatim.

Hartimi i këtij projektligji u bë pas nënshkrimit të dy memorandumeve:

- Memorandumit të bashkëpunimit ekonomik, për projektet dhe blerjet në vendin tonë, ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, miratuar me vendimin nr.785, datë 7.10.2020, të Këshillit të Ministrave;
- Memorandumit të mirëkuptimit për bashkëpunim, lidhur me projektin e HEC Skavicë, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë “Bechtel International Inc.”, nënshkruar më 3 tetor 2020.

Projektligji përcakton strukturën e kontratës me Shoqërinë Bechtel, si dhe procedurat dhe afatet për negocimin dhe miratimin e kontratës dhe për realizimin e projektit.

Kontrata do të hartohet dhe nënshkruhet nga palët:

- Pala shqiptare përfaqësohet nga KESH, sha, në cilësinë e autoritetit kontraktor. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë mbikëqyr gjithë procesin, nga firmosja, deri tek zbatimi i plotë i kontratës;
- Pala e huaj është Shoqëria “Bechtel”.

Projekti do të zhvillohet në dy faza, të cilat do të kenë kontrata të veçanta.

- Kontrata për fazën e parë ka objekt matjet topografike, studimet hidrologjike e gjeoteknike, zhvillimin e strategjisë për realizimin e projektit, vlerësimin mjedisor e social, përcaktimin

e projektit teknik dhe të kostove etj. Kjo kontratë do të nënshkruhet nga KESH, sha dhe Bechtel. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i paraqet Këshillit të Ministrave kontratën e nënshkruar nga palët. Kontrata miratohet nga Këshilli i Ministrave. Shpenzimet për fazën e parë të projektit do të përballohen nga Shoqëria “KESH”, sha.

- Kontrata për fazën e dytë ka objekt projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, paraqet projektligjin për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës në Kuvend, i cili e miraton atë.

Procedura e negociimit për fazën e dytë të kontratës do të zhvillohet nga Komisioni i Negocimit, i cili do të krijohet nga Këshilli i Ministrave, me përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, disa ministri të tjera dhe KESH, sha. Komisioni i negociimit të kontratës do të asistohet nga një konsulent, i përzgjedhur nga Avokatura e Shtetit.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me *Acquis Communautaire*.

Ky projektligj nuk ka qëllim përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire* të Bashkimit Europian.

V. Konsultimi publik.

Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji nuk kishte përfaqësues nga shoqëria civile dhe grupet e interesit.

VI. Efektet financiare.

Projektligji nuk do të sjellë efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit në këtë fazë. Gjatë zbatimit të projektit do të përcaktohen shpenzimet dhe burimet e financimit të tyre.

VII. Diskutimi në Komision.

Znj. Belinda Balluku, Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, paraqiti projektligjin dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve.

Z. Anastas Angjeli, në cilësinë e relatorit, paraqiti opinionin e tij për projektligjin, duke e konsideruar mjaft të rëndësishëm, pasi bën të mundur fillimin e projektimit dhe ndërtimit të Hidrocentralit të Skavicës, pas një faze studimore të nisur prej vitesh. Ky hidrocentral është një investim shumë i rëndësishëm strategjik për zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike. Projektligji është në përputhje me Kushtetutën, Rregulloren e Kuvendit dhe legjislacionin në fuqi.

Projektligji është në përputhje me ligjin nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, i cili përcakton rregullat për kryerjen e procedurës së veçantë, si një

procedurë administrative, me të cilën jepet mbështetje me rregulla të veçanta për investime strategjike me ndikim në ekonomi, punësim, industri, teknologji dhe zhvillim rajonal, me synim lehtësimin dhe përshpejtimin e investimeve.

Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit Ekonomik me SHBA-në dhe i Memorandumit të Mirëkuptimit me Shoqërinë “Bechtel International Inc.” shërbejnë si bazë për hartimin e këtij projektligji.

Gjithashtu, projektligji është në përputhje me Kodin Zgjedhor (veçanërisht me nenin 91, pika 4 të tij), për arsye se:

- **Së pari**, ky projektligj është nisur që në muajin tetor 2020, me anë të nënshkrimit të marrëveshjeve nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- **Së dyti**, ky projektligj nuk synon dhënien e një të drejte me koncesion/PPP, por krijimin e hapësirës ligjore të kontraktimit direkt të shoqërisë “Bechtel” për projektimin dhe ndërtimin e HEC-it të Skavicës, në përputhje me kushtet e parashikuara në projektligj.

Në përfundim, relatori kërkoi nga propozuesit e projektligjit një informacion më të plotë mbi dhënien e statusit “investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë” ndaj Shoqërisë “Bechtel International Inc.”.

Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë informoi Komisionin se hartimi i këtij projektligji mbështetet në Memorandumin e Bashkëpunimit Ekonomik me SHBA-në. Shoqëria “Bechtel International Inc” nuk ka aplikuar për marrjen e statusit të investitorit strategjik, pasi ky status nuk i është kërkuar nga pala shqiptare. Kjo shoqëri plotëson kriteret e nevojshme ligjore për projektimin dhe ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës.

Me tej, Ministrja theksoi se investimi për kontratën e parë do të kryhet me fondet e vëna në dispozicion nga Shoqëria “KESH”, sha. Për kontratën e dytë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë po bashkëpunon me Korporatën Financiare për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (DFC) dhe me Shoqërinë “Bechtel International Inc.” për sigurimin e financimit të huaj, i cili do jetë në formën e kredisë.

VIII. Përfundim.

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin me shumicë votash, me disa ndryshime, si më poshtë:

- **Kudo ku përmenden në ligj**, fjalët “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë” të zëvendësohen me fjalët “ministra përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë”.

- Në **nenin 2, pika 3**, fjalia e dytë të riformulohet si më poshtë:

“Shpenzimet për mbulimin e kontratës së fazës së parë mbulohen nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare.”.

- Në **nenin 3**, titulli i nenit të riformulohet si më poshtë:

“Procedura e negocimit të kontratës”.

KRYETARI

Anastas ANGJELI